



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësta Org. Org.Jedinica Org.Unit	SP-02
Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No.	356-2/26
Nr. ffaqeve Broj.stranica No.pages	- 06 -
Data Datum. Date	22.04.2020
PRISHTINEJA	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	08.04.2026
<b>REFERENC-Ë:</b>	26/356/33/DMM
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"ohm" Sh.p.k. Prishtinë
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/356/33/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

1. Vendimi për Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "ohm" Sh.p.k. Prishtinë, për parkun fotovoltaik 1.5 MWp në ngastrën kadastrale nr. P-70705066-00663-0 në Z.K. Rracaj, Gjakovë.

2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

Me respekt,

Faqe 1 nga 6



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**  
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**  
**Ministry of Environment and Spatial Planning**

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958/23 datë 13.07.2023), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:


**V E N D I M**

Kompania "ohm" Sh.p.k. Prishtinë, **pajiset me Pëlqim Mjedisor** për parkun fotovoltaik 1.5 MWp në ngastrën kadastrale nr. P-70705066-00663-0 në Z.K. Rracaj, Gjakovë, nën kushtet si vijon:

**Kushtet e përgjithshme mjedisore:**

1. OE është i obliguar të zbatojë të gjitha fazat e projektit në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi, standardet teknike të BE-së dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
2. Zbatimi i projektit nuk duhet të cenojë cilësinë e ajrit, ujit, tokës apo biodiversitetit në zonën përreth.
3. Aktivitetet ndërtimore dhe operuese duhet të organizohen në mënyrë që të minimizohen ndikimet mjedisore, sociale dhe vizuale.
4. Para fillimit të punimeve, OE duhet të ketë të gjitha lejet ndërtimore, energjetike dhe leje dhe licenca tjera të nevojshme të lëshuara nga autoritetet përkatëse.

Faqe 2 nga 6



### *Kushtet për fazën e ndërtimit:*

#### *1. Menaxhimi i pluhurit dhe zhurmës*

- 1.1. Të përdoren mjete transporti dhe makineri në gjendje të mirë teknike për të ulur emetimet dhe zhurmën.
- 1.2. Të bëhet spërkatje e rrugëve të brendshme me ujë për të reduktuar pluhurin.
- 1.3. Gjatë punimeve të transportit të materialeve (rërë, zhavorr, dhe), mjetet të jenë të mbuluara për të shmangur shpërndarjen e materialeve.

#### *2. Menaxhimi i tokës dhe peizazhit*

- 2.1. Të kufizohet ndërhyrja vetëm në sipërfaqet e nevojshme për vendosjen e paneleve, rrugëve teknike dhe infrastrukturës mbështetëse.
- 2.2. Toka pjellore e hequr gjatë ndërtimit të ruhet dhe të përdoret për rehabilitimin e zonave pas përfundimit të punimeve.
- 2.3. Ndalohet prerja e drunjve ose shkatërrimi i habitateve pa leje paraprake nga autoritetet përkatëse.

#### *3. Menaxhimi i mbetjeve ndërtimore*

- 3.1. Të gjitha mbetjet e ngurta që krijohen gjatë fazës së ndërtimit (metal, beton, plastikë, kablo, etj.) të klasifikohen dhe dorëzohen te operatorët e licencuar për menaxhim të mbetjeve.
- 3.2. Mbetjet e rrezikshme (vajra, bateri, lubrifikantë) të ruhen në enë të veçanta, të shënuara dhe të mbyllura, në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2013 për Mbetjet e Rrezikshme.
- 3.3. Nuk lejohet asnjë depozitë e paautorizuar brenda ose jashtë zonës së projektit.

### *Kushtet për fazën e operimit*

#### *1. Ndikimi në ajër dhe tokë*

- 1.1. Operimi i parkut nuk duhet të krijojë ndotje të ajrit, përveç pluhurit minimal nga mirëmbajtja dhe transporti.
- 1.2. Rrugët e brendshme të jenë të stabilizuara (të shtruara me zhavorr ose asfalt) për të reduktuar erozionin.
- 1.3. Nuk lejohet përdorimi i kimikateve të rrezikshme për pastrimin e paneleve (të përdoret vetëm ujë i pastër ose solucione të miratuara mjedisore).



## **2. Menaxhimi i ujërave**

- 2.1. Ujërat e shiut të grumbulluara nga panelet të menaxhohen përmes kanaleve të drenazhit dhe pusetave absorbuese.
- 2.2. Të sigurohet që drenazhi nuk shkakton erozion ose ndotje në tokat përreth.
- 2.3. Në rast të përdorimit të ujit për pastrimin e paneleve, duhet të aplikohet kursim i ujit dhe riciklim i mundshëm i ujërave të përdorura.

## **3. Menaxhimi i mbetjeve**

- 3.1. Të krijohet Plan i Menaxhimit të Mbetjeve të Operimit, që përfshin mbetjet nga mirëmbajtja e pajisjeve, paneleve dhe kabllave.
- 3.2. Panele të dëmtuara, inverterë, apo pajisje elektrike duhet të dorëzohen operatorëve të licencuar për mbetjet elektrike dhe elektronike (WEEE).
- 3.3. Të ruhet regjistri vjetor i mbetjeve dhe raporti i dorëzohet Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

## **4. Kontrolli vizual dhe estetik**

- 4.1. Duhet të ruhet pamja vizuale e zonës duke gjelbëruar hapësirat e rrethuara dhe duke përdorur gardhe të përshtatshme për mjedisin rural.
- 4.2. Duhet të shmangët reflektimi i tepërt i dritës duke përdorur panele me sipërfaqe antirefleksive.
- 4.3. Ndalohet ndërhyrja në objekte kulturore, arkeologjike ose në zona të mbrojtura.

## **5. Kushtet për fazën e mbylljes**


- 5.1. Çmontimi i plotë i paneleve fotovoltaike, strukturave metalike, kabinave elektrike, inverterëve dhe kabllave.
- 5.2. Rikthimi i mikro-topografisë së zonës në gjendjen fillestare ose të ngjashme me gjendjen natyrore.
- 5.3. Vendosja e shtresës humusore të ruajtur gjatë ndërtimit ose furnizimi me shtresë të re vegjetative.

Nëse nuk plotësohen kushtet e lartcekura, pëlqimi do të anulohet (revokohet).

## **A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës për Pëlqim Mjedisor nga Komisioni për VNM, dokumantacionin përcjellës të dorëzuar nga Kompania "ohm" Sh.p.k. Prishtinë për

Faqe 4 nga 6



parkun fotovoltaik 1.5 MWp në ngastrën kadastrale nr. P-70705066-00663-0 në Z.K. Rracaj, Gjakovë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nxjerrë Vendim për lëshuarjen e Pëlqimit Mjedisor.

Ky Pëlqimit Mjedisor lëshohet konform nenit 29 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181

### **Operatori është i obliguar me Ligj, që të aplikoj për Leje Mjedisore**

Ky Pëlqim Mjedisor vlen dy vite konform nenit 21 te Ligjit për VNM 08/L-181.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/356/- ZSP/ /26 datë: 08.04.2026

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Gjakovës
7. Divizionit për komunikim me publikun
8. Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore
9. Arkivit të MMPHI

Bajram Kafexholli

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH

2. SHTOJCË : Detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 për procedurën e mëtejshme, (neni 31. pika 1, 2. dhe neni 35).

### **Neni 31.**

#### Leja Mjedisore

1.Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

2.Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesëvjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë.

### **Neni 35.**

#### Planet e intervenimit në rast të aksidentit mjedisor

1. Për rastet e aksidentit të mundshëm mjedisor ose të ndonjë ndodhie që posaçërisht e rrezikon mjedisin ose shëndetin e njeriut, Qeveria nxjerr plane të intervenimit dhe informon Kuvendin.

2. Planet e intervenimit nga paragrafi 1. të këtij neni përmbajnë: llojet e rrezikshmërisë; procedurat dhe masat për zbutjen dhe eliminimin e pasojave të drejtpërdrejta për mjedisin dhe shëndetin e njeriut; subjektet për zbatimin e masave të caktuara; përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me zbatimin dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave për intervenim të cilat zbatohen sipas ligjit.

3. Planet e intervenimit për prodhimet, pajisjet dhe stabilimentet, të cilat me veprimtarinë e tyre mund të shkaktojnë ndotje të mjedisit, i harton prodhuesi.

4. Komuna është e obliguar të nxjerr planin e intervenimit për territorin e vet.

5. Përmbajtjen e planeve, procedurat dhe masat e zbatimit, subjektet e zbatimit të masave të caktuara, llojet e pajisjeve, stabilimenteve, dhe llojet e proceseve prodhuese sipas paragrafit 3. të këtij neni, Ministri e përcakton me akt nënligjor.

